REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK DIVJAKË

Nr. 8262/22 Prot.

Divjakë, më 23. 10. 2026

Projekt - Vendim

Nr.96 datë 23.10.2026

"Autorizimi i Kryetarit të Bashkisë Divjakë, z. Josif Gorrea, për të përfaqësuar Bashkinë Divjakë, në Gjykatën Kushtetuese, për shqyrtimin e kushtetutshmërinë së reformës së re administrative-territoriale 2026"

Në mbështetje te nenit 113,134 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 53, pika 4, nenit 54, pika (h) të Ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, Rregullores së Funksionimit të Këshillit të Bashkisë Divjakë, miratuar me VKB nr.28 datë 13.04.2020, ndryshuar më VKB Nr.48 datë 25.09.2023, i propozojmë Këshillit Bashkiak në mbledhjen e datës 23.10.2026:

1. Të miratojë "Autorizimin e Kryetarit të Bashkisë Divjakë, z. Josif Gorrea, për të përfaqësuar Bashkinë Divjakë, në Gjykatën Kushtetuese, me qëllim paraqitjen e kërkesës për shqyrtimin e kushtetutshmërinë së reformës së re administrative-territoriale 2026, (e miratuar në Kuvendin e Shqipqërisë), në përputhje me legjitimin kushtetues të subjektit kërkues. Këshilli Bashkiak të shqyrtojë nevojën e mbrojtjes së interesave të Bashkisë Divjakë, të autonomisë vendore dhe të parimeve kushtetuese që lidhen me organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore.
2. Propozohet që Këshilli Bashkiak të vlerësojë dhe të vendosë për autorizimin e Kryetarit të Bashkisë për të ndërmarrë veprimet e nevojshme ligjore dhe procedurale, përfshirë përfaqësimin e Bashkisë dhe paraqitjen e kërkesave përkatëse përpara Gjykatës Kushtetuese, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe kriteret kushtetuese të legjitimimit.
3. Ngritjen e një Komisioni të Posaçëm për monitorimit e procesit gjyqësor.

5. Për zbatimin e këtij Prokjet-Vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Divjakë dhe struktuarat përgjegjëse të Bashkisë Divjakë.

NËNKRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

EUGEN VERDHA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIVJAKË